



**KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE
DREJTORIA PER EKONOMI DHE FINANCA
MALISHEVE;DATE 07/07/2015**

**RAPORT I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE PËR PERIUDHEN
JANAR-QERSHOR 2015**

Malishevë, Korrik-2015

HYRJE:

Në bazë të Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048 si dhe Ligjit nr.03/L-221 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-048 gjegjësisht nenit 6.3,6.4 si dhe nenit 45, për raportimet vjetore dhe periodike mbi menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit ,Organizatata buxhetore janë të obliguara ti paraqesin pasqyrat financiare.

Prandaj Drejtoria për Buxhet dhe financa ka përpiluar raportin financiar për periudhën **Janar-qershor 2015** në bazë të standardeve të Kontabilitetit dhe procedurave të thesarit mbi të hyrat dhe shpenzimet e ndodhura në këtë periudhë.

Sipas të dhënave të prezentuara në tabelat përkatëse del se K.K-Malishevë ka një buxhet të miratur nga Kuvendi për vitin fiskal-**2015**, në shumën prej **11,868,943.20€**për të gjitha programet dhe nënprogramet.Kur kësaj I shtohen mbetjet e vogla të donacioneve nga vitet e kaluara dhe donacionet e deri tanishme të vitit aktual prej **90,866.39€**dhe të hyrat e bartura nga viti **2014**,në shumë prej **236,940.65€**dhe të regjistruara në SIMFK,buxheti për vitin fiskal 2015, kap shumën prej **12,196,750.24€**

Kurse buxheti I alokuar për këtë gjashtëmuor (**Janar-qershor 2015**) kap shumën prej:**7,796,045.52€**çka do të thotë se shkalla e realizimit të buxhetit është **63.92%**.

Sipas shënimeve që janë në librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar(alokuar) për periudhën **Janar-qershor 2015** është **72.85%**.

Në faqën e dytë janë dhënë tabelat e planit të buxhetit dhe realizimi i tij sipas programeve,sipas burimeve(fondeve),dhe sipas kategorive ekonomike për periudhën Janar-qershor 2015.

Plani I realizimit të të hyrave vetanake për periudhën Janar-qershor 2015,është:të hyrat e rregullta janë 271,501.14€Këto të hyra janë të futura në sistem dhe gjithashtu janë alokuar,kurse të hyrat të cilat arkëtohen nga gjobat e gjykatave për periudhën,janar-qershor 2015 deri në momentin e raportimit nuk ka mbërri raporti nga thesari,prandaj akoma nuk kemi njohuri për shumën e këtyre mjeteve.

Kurse gjobat në trafik për këtë periudhë kapin shumën prej 16,766.00€të cilat gjithashtu janë alokuar.Pra të hyrat vetanake të realizuara për këtë periudhë kapin shumën prej 288,267.14€

Pra sipas shënimeve aktuale, në këtë periudhë përqindja e realizimit të të hyrave vetanake në krahasim me panifikimin është(288,267.14/755,908.00)=38.14%.